



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery | 09.02.2021 | 21 | Vitet Year |
| Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojta Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SK PMS Hek | 58/2021 | | 1/3 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.419/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.419/2020 të datës 14.12.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë Rr. "Hys Popova", Nr.139 në Prishtinë, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministritë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/mos vazhdim i kontratës së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 09.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.419/2020 e datës 14.12.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] më datë 14.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3126/2020 të regjistruar me numër A.nr.419/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos vazhdimin e mandatit si „Kryeshef Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijen e Ankesave, më datë 20.01.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Sekretariati Koordinuar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, po ashtu me datë 05.01.2021 nga Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli më datë 21.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.12.2020 me Nr.prot:3126/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbim Civil të Kosovës; Emalin zyrtar të datës 08.01.2021 nga ankuesi; Vendimin Nr.1135 të datës 15.12.2020; Akt emërimi AE.Nr.24/2021 i datës 06.01.2021 i ankuesit; Vendimi Nr.08/150 i datës 21.07.2017; Njoftimi i datës 28.08.2020; Vendimi Nr.1052 i datës 27.11.2020; Emali zyrtar i datës 01.12.2020; Emali zyrtar i datës 30.11.2020; Emali zyrtar i datës 27.11.2020; Vendimi Nr.1088 i datës 02.12.2020; Emali zyrtar i datës 04.12.2020; Vlerësimi i përgjithshëm për ankuesin nga ministri i MTI-së; Formulari për objektivat vjetore; Emali zyrtar i datës 07.12.2020; Kërkesa për përgjigje e datës 05.01.2021 si dhe e datës 20.01.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 21.01.2021; Vendimi Nr.08/150 i datës 21.07.2017; Vendimi Nr.12/194 i datës 23.07.2014; Vendimi Nr.13/26 i datës 27.07.2011.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pa lejuar sepse:

Ankuesi, në bazë të Vendimit me Nr. 13/26 të datës 27.07.2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është emëruar në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit“ me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa në bazë të Vendimit me Nr. 12/194 të datës 23.07.2014 dhe Vendimit Nr.08/150 të datës 21.07.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i është vazhduar mandati në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit“ edhe për tri (3) vite tjera (deri më datë 21.07.2020). Emërimi i ankuesit në pozitën e „Kryeshefit Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit, është bërë sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu ka konstatuar se me datën 14.07.2020, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. _____, ka bërë vlerësimin e performancës së punës së ankuesit dhe ka rekomanduar vazhdimin e mandatit të ankuesit _____ në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit“, dhe po ashtu me të njëjtën datë përmes e-mailit zyrtar ankuesi ku është njoftuar edhe Ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. _____ ka kërkuar nga Drejtori i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. _____ që të vihet në rend ditë për shqyrtim dhe miratim propozim- vendimi për vazhdimin e mandatit të „Kryeshefit Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit, mirëpo Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk ka shqyrtuar propozimin e Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit“.

Ankuesi, duke marr parasysh se nuk ka pranuar përgjigje në kërkesat e tij drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 14.12.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 3126 të regjistruar me numër A.nr.419/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me shqyrtimin e propozimit të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vazhdimin e mandatit në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit, dhe po ashtu ai pretendon se është diskriminuese mos dhënia e mundësisë për ri zgjatje të mandatit në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Agjencinë Kosovare të Standardizimit“, ashtu siç përcaktohet me nenin 42 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta

këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrahet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Vendimit me numër Nr.08/150 të datës 21.07.2017, ku shihet se ankuesit i ka përfunduar mandati me datë 12.07.2020, si dhe kërkesën-emalin zyrtar të datës 14.07.2020, të ankuesit ku është njoftuar edhe Ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. [redacted] drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht, Drejtorit të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shqyrtimin dhe miratimin e propozim-vendimit për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën "Kryeshef Ekzekutiv" në Agjencinë Kosovare të Standardizimit, Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 14.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.419/2020

Hysni Mustafa

Procesmbajtës

Malsore GASH-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, [redacted]
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.